



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 17, shkronja **b**, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 17 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 04/L-174, korrik 2013), nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2017, merr këtë

V E N D I M
PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË BLOKUT "C-5"
NË KUADËR TË PLANIT RREGULLUES URBAN "MEDRESE - ÇAMËRI"

Neni 1
Lloji i dokumentit

Miratohet Vendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut "C-5", i cili gjendet në kuadër të Planit rregullues urban "Medrese - Çamëri", në Prishtinë.

Neni 2
Qëllimi

Ndryshimi i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, ka të bëjë me ndryshimin e destinimit të planifikuar të parcelës nr. 2129-0, ZK Prishtinë, në kuadër të bllokut "C-5", të Planit rregullues urban "Medrese - Çamëri" Prishtinë, gjegjësisht një pjesë e kësaj parcele do të destinohet për ndërtimin e institucionit parashkollor.

Neni 3
Organet për zbatim

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Organet e tjera përkatëse kompetente, do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij vendimi nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

**Neni 4
Përmbajtja**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tekstuale dhe grafike e ndryshimit të bllokut "C-5".

**Neni 5
Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 350/05-0182467/17, më 26.07.2017.



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.